



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INVESTIMEVE DHE**  
**INFRASTRUKTURËS**

---

**Nr.4277 Prot**

**Shkodër, më 18.03.2019**

**Lënda:       Përgjigje kërkesë për informacion**

\_\_\_\_\_

**Rruga \_\_\_\_\_, Tiranë**

**e.mail: \_\_\_\_\_**

Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike dhe rregjistruar me nr.3852 prot, datë 11.03.2019, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion për sipërfaqen e gjelbërt në Bashkinë Shkodër, ju bëjmë me dije se:

Sipërfaqja e gjelbërt e përgjithshme është 338.000 m<sup>2</sup>, nga të cilat, 99.000 m<sup>2</sup> janë lulishte, 39.000 m<sup>2</sup> gjelbërim rrugor, 100.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbërt në kopshte, çerdhe, shkolla etj, 100.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbërt në oborre, bahçe dhe biznese.

Sipërfaqja e gjelbërt për banorë, brenda vijës së verdhë të qytetit është 3.84 m<sup>2</sup> për banorë. Popullsia e qytetit është 87.853 banorë.

Masat e marra për gjelbërimin e qytetit, kanë të bëjnë me shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta me anë të investimeve, shtimin e gjelbërimit rrugor nëpërmjet mbjelljes së drurëve dhe rikonstruksionit të lulishteve ekzistuese.

Shuma në lekë e investuar për gjelbërimin për periudhën 2015 – 2018, është si në vijim: për vitin 2015 investimi është në shumën 30.769.870 lekë, për vitin 2016 në shumën 30.768.992 lekë, për vitin 2017 në shumën 30.769.870 lekë dhe për vitin 2018 në shumën 38.503.708 leke.

Për më shumë informacion mund të klikoni në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër, [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), tek Transparenca e Buxhetit në zërin Shpenzime tek Shërbimet Publike, ose në linkun <http://buxheti.info/shkoder/>, ku mund të gjeni informacion

më të detajuar për shpenzimet e vitit 2016, 2017 dhe 2018, duke përfshirë dhe kontratat e lidhura me subjektet.

Përsa i përket, numrit të personave të vdekur nga sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes nga viti 2015 deri në vitin 2018, nuk kemi informacion.

**KRYETAR**

\_\_\_\_\_  
**Voltana ADEMI**